

VENDIM
Nr. 494, datë 19.6.2013

**PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE MBI SIPËRFAQET TAKUESE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15/1 e 32, pika 1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale në Durrës, Vlorë, Korçë, Elbasan e Tiranë. Pronarët e pasurive të paluajtshme, për sipërfaqen e zënë nga ndërtimet informale, të shpërblehen sipas masës përkatëse që paraqitet në listën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 10 716.50 (dhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë) m², tokë truall, me vlerë të përgjithshme 176 171 618.80 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë) lekë.

2. Vlera e përgjithshme e shpërblimit të përballohet nga fondi i kompensimit të pronave, të parashikuar nga ligji nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”.

3. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me këtë vendim, të kryejë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme për kalimin e pasurisë së paluajtshme të kompensuar në pronësi të shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha